



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 874/5 prot

Datë 01.04.2026

V E N D I M
Nr. 451/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.04.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me numër 874 prot., datë 18.03.2026 si dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6442, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-76162-02-13-2026, me objekt “Loti i V-të: Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i rrugës kryesore të fshatit Kasallë” me fond limit: 1,123,594.99 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27-02 2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Tirane me adresë: Sheshi “Skënderbej”, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” sh.p.k me NIPT K72113010E, dhe adresë: Rruga Mujo Ulqinaku, Objekti Nr.23, Z.1, Tiranë.
- Subjekt i Interesuar:** Operatori Ekonomik BOE “ProStruct” shpk & “2H Construction” shpk me NIPT M51414009M dhe M04619001D dhe adresë Rr: "Reshit Petrela", Nr.Pasurie 7/143+1-28,Zk.8330, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nwn kufirin e ulwt monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16-02-2026 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-76162-02-13-2026, me objekt “Loti i V-të: Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i rrugës kryesore të fshatit Kasallë” me fond limit: 1,123,594.99 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27-02 2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane.

II.2. Në datë 27-02-2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datë 05.03.2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

BN PROJECT shpk	0,00 pikë
IMES-D shpk	0,00 pikë
ProStruct sh.p.k	156 pikë
DERBI-E sh.p.k	154,80 pikë
INFRATECH sh.p.k	154,80 pikë
Noor Engineering sh.p.k	154,80 pikë
TOWER sh.p.k	153,60 pikë
A & E ENGINEERING sh.p.k	153,60 pikë
MAGNA CHARTA sh.p.k	153,60 pikë
M.A.K Studio sh.p.k	151,20 pikë
PROJECT DALUZ 2019 sh.p.k	150,00 pikë
MIKI CONSULTING sh.p.k	150,00 pikë

II.4. Në datën 18-03-2026, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraparak për procedurën e prokurimit objekt ankimi, ku rezulton se është shpallur fitues OE “ProStruct” shpk.

II.5. Në datën 18.03.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 874/2026 protokoll, datë 18.03.2026 e operatorit ekonomik “A & E ENGINEERING” sh.p.k për procedurën e prokurimit Nr. REF-76162-02-13-2026, me objekt “Loti i V-të: Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i rrugës kryesore të fshatit Kasallë” me fond limit: 1,123,594.99 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27-02-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 874/1 datë 19.03.2026, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin me pikë të ofertës teknike të paraqitur nga operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” sh.p.k në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.7. Në datë 01.09.2025 nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë dorëzuar argumente nga subjekte tw intersuar, në përputhje me afatet e parashikuar në nenin 113 të LPP-së.

II.8. Me anë të shkresës nr. 208 prot., datë 01.04.2026, protokolluar me tonwn nr.874/2 datw 01.04.2026 në Komisionin e Prokurimit Publik eshte dorezuar nga operatori ekonomik “A&E Enginnering” SHPK shkresa me objekt: “Tërheqjen nga ankimimi”, me anë të së cilës informohet ky Komision si vijon:

“Pranë Komisionit të Prokurimit Publik është duke u shqyrtuar ankesa Nr.Aplikimi online A/2026/6442 më datë 18/03/2026, e paraqitur nga shoqëria "A&E Engineering" sh.p.k, per objektin: Loti i V-të: Mbikqyrja e punimeve për objektin: "Rehabilitimi i rrugës kryesore të fshatit Kasallë", me fond limit 1,123,594.99 (një milion e njëqind e njëzet e tre mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër pikë nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, autoriteti kontraktor: Bashkia e Tiranës. Bazuar në paragrafin e parë të nenit 117 të LPP-së, deklarojme dhe kërkojme terheqjen nga shqyrtimi i ankesës së paraqitur si më sipër cituar".

Kjo tërheqje bëhet për shkak të rishikimit të rrethanave dhe prioriteteve për objektin specifik.

Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë dhe të procedoni me mbylljen e ankeses për objektin e sipërpërmendur.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “A & E ENGINEERING” SHPK për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-76162-02-13-2026, me objekt “Loti i V-të: Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i rrugës kryesore të fshatit Kasallë” me fond limit: 1,123,594.99 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27-02 2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet: *“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës. 2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”*

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues ““A & E ENGINEERING” SHPK për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës

numër 874 prot., datë 18.03.2026 si dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6442, për procedurën objekt shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për ankesën e operatorit ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-76162-02-13-2026, me objekt “Loti i V-të: Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i rrugës kryesore të fshatit Kasallë” me fond limit: 1,123,594.99 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 27-02 2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

